

# ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TE ENERGIJISE

## METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË TARIFAVE TE SHITJES ME PAKICË PËR KLIENDET TARIFORE ( PER FURNIZUESIN PUBLIK ME PAKICE)

### PJESA I

#### **Autoriteti**

Kjo metodologji per llogaritjen e tarifave te furnizuesit publik eshte zhvilluar bazuar ne Ligjin Nr 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e Energjise Elektrike”, i ndryshuar.

#### **Qellimi**

Qellimi i kesaj metodologjie eshte vendosja e tarifave te rregulluara per shitjet tek konsumatoret fundore te energjise elektrike, bazuar ne parimet e njohura ekonomike dhe ti siguroje te licensuarit, Furnizuesit Publik me Pakice (ose FPP), mundesine e nje norme fitimi te arsyeshme.

#### **Objektivi**

Objektivi afatshkurter i kesaj metodologjie tarife eshte te siguroje nje kuader te bazuar ne kosto per llogaritjen e çmimit te energjise elektrike shitur klienteve tarifore dhe per te transmetuar sinjalet e duhura te cmimeve per perdorim eficient te energjise.

### **1. Termat e perdorur ne metodologji**

Termat standarte te perdorur ne gjithe metodologjite e tarifave percaktohen ne Ligjin “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, Rregullat e Tregut, Kodin e Matjes, Kodin e Transmetimit dhe aktet e tjera nenligjore te miratuara nga ERE. Termat e perdorur ne kete metodologji kane kuptimin si me poshte

- 1.1 Tarifa mesatare per shitjet e energjise elektrike tek konsumatoret tarifore** – te ardhurat mesatare per kWh nga shitjet tek konsumatoret tarifore gjate nje periudhe 12 mujore, te llogaritura si te ardhura totale nga pagesat qe lidhen me kapacitetin, pagesat qe lidhen me energjine dhe pagesat fikse mujore pjestuar me totalin e kWh, qe i levrohet konsumatoreve tarifore.
- 1.2 Kapaciteti i livruar** – nje vleresim i ngarkeses totale te konsumatorit ne MW e cila mund te furnizohet ne menyre te qendrueshme nga sistemi i shperndarjes gjate vitit tarifore.

- 1.1 **Parashikimi i ngarkeses se matur** – parashikimi i zhvilluar bashkarisht midis FPP, Operatorit te Sistemit te Transmetimit (ose OST) dhe Furnizuesit Publik me Shumice (ose FPSH) per shitjet e energjise dhe ngarkesen pik me supozimin qe e gjithë ngarkesa sherbehet (nuk ka nderprerje ) per klientet tarifore, shitjet e energjise dhe ngarkesat pik per klientet jo-tarifore, humjet totale, teknike dhe jo-teknike te energjise ne rrjetin e shperndarjes, dhe parashikimi i prodhimit te energjise elektrike nga PVE te lidhur ne rrjetin e shperndarjes.
- 1.2 **Tarifat e diferencuara** – tarifat per sherbimin e konsumatoreve qe perfshijne pagesat qe lidhen me kapacitetin, pagesat qe lidhen me energjine dhe pagesat fikse mujore sipas niveleve perkatese te tensionit.
- 1.3 **Blloku i rritur i konsumit** – Blloku me i larte i KWh-ve ne tarife per te gjithë klientet, ne te cilin reflektohen kostot shtese te energjise per sistemin energjetik.
- 1.4 **Viti Tarifor** – periudha 12-mujore pergjate te ciles tarifat e aprovuara nga ERE aplikohen ne faturat mujore te energjise per klientet tarifore.
- 1.5 **Tregu Rajonal i Energjise Elektrike** – tregu konkurues i energjise elektrike qe operon ne Shqiperi, Austri, Bosnie-Hercegovine, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Greqi, Hungari, Mal i Zi, Rumani, Serbi, Slloveni, Kosove, dhe Turqi, bazuar ne kuadrin ligjor te Direktivave te BE, 2003/54/EC.
- 1.6 **Viti testues** – periudha 12-mujore perpara vitit tarifor qe perdoret si baze per perpunimin (parashikimin) e te ardhurave te kerkuara per vitin tarifor per furnizuesin publik me pakice.

## 2. Rregullat e pergjithshme dhe parimet baze

- 2.1 Mosperputhja me ndonje pjese te kesaj rregullore mund te rezultoje ne refuzimin nga ana e ERE-se te aplikimit per tarife te Furnizuesit Publik me Pakice (FPP).
- 2.2 Kjo metodologji eshte hartuar mbeshtetur ne Ligjin nr.9072 date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, i ndryshuar, ne Modelin Shqiptar te Tregut te aprovuar nga Qeveria e Shqiperise, ne aktet e tjera ligjore qe jane ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe ne aktet ligjore sekondare te miratuara nga ERE.
- 2.3 ERE do te vendose tarifat bazuar ne parimet e meposhtme:
  - Nuk duhet te kete ndersubvencionim midis grupeve te konsumatoreve (tarifat duhet te reflektojne koston aktuale te sherbimit per cdo grup te konsumatoreve tarifore)
  - Tarifat duhet te japin sinjalet e duhura te çmimeve per perdorimin eficient te energjise elektrike
  - Shpenzimet e perfshira ne tarifa duhet te jene te drejta dhe transparente per te gjithë palet e interesuara

- Tarifat duhet të mbulojnë të gjithë shpenzimet e arsyeshme për FPP, dhe ky i fundit do të paguaje të gjithë detyrimet ndaj të licensuarve të tjerë të sektorit, në kohë dhe në shumën e plote të faturave
- Tarifat duhet të lejojnë FPP që të realizojë një normë të arsyeshme fitimi mbi të ardhurat e miratuara nga ERE.
- Klientet buxhetore do të paguajnë faturat e energjisë në kohë dhe sasinë e plote.
- Vetëm shërbimet e arsyeshme të blera nga Furnizuesi Publik me Pakicë do të pranohen në tarifa
- Çmimet për energjinë elektrike duhet të mbeten relativisht të qëndrueshme për gjatë kohës

### **3. Viti i Testimit dhe Viti tarifor.**

- 3.1 ERE do të aprovojë çdo vit tarifa për FPP.
- 3.2 ERE miraton tabelat standarte për aplikimet e tarifave si Pjesë e dytë e kësaj metodologjie. Furnizuesi Publik me Pakicë do të përdorë tabelat e siguruar nga ERE për të depozituar të dhëna për vitin e testimit dhe axhustimet për vitin tarifor. Format i tabelave mund të modifikohet për sa kohë që informacioni është organizuar në mënyrë të ngjashme dhe detajimi i informacionit është jo më pak se ajo që parashikohet në tabelat standarte të miratuara. Tabelat do të tregojnë rezultatet e vitit të testimit, rregullimet e bëra në rezultatet e vitit të testimit duke përfshirë por pa u kufizuar në shpenzimet e kompanisë, shpenzimet e kapitalit, dhe bazën e asetëve të rregulluar për shërbimet e rregulluara.
- 3.3** Kerkesat për të ardhura të FPP është rezultat i kostove të parashikuara të të licensuarve të tjerë të rregulluar të sektorit dhe kosto e tij e operimit. Çdo rritje vjetore në tarifën për të licensuarit e tjerë do të reflektohet në tarifën për FPP.
- 3.4 Viti i testimit për vendosjen e kostove baze financiare do të bazohet në informacionin kontabel në përputhje me Sistemin Uniform të Llogarive të miratuar nga ERE. Viti i testimit duhet të jetë një periudhë historike përfaqësuese 12 mujore e kostove operative të kompanisë. ERE ka të drejtën të realizojë, ose të kontrakttojë për të realizuar një auditim rregullator të informacionit kontabel të vitit të testimit të FPP gjatë procesit të aplikimit të tarifave.
- 3.5 Furnizuesi Publik me Pakicë mund të propozojë ndryshime ndaj rezultateve të shpenzimeve të vitit të testimit për vendosjen e tarifave për vitin tarifor. Çdo ndryshim duhet të jetë i njohur si artikull dhe i matshëm nga ana sasiore. Fondet e emergjencës për të mbuluar kostot e parashikuara nuk do të miratohen nga ERE. ERE do të reflektojë rregullimet/korrigjimet e rezultateve të vitit të testimit të tilla si:

- 1) Rritje apo zvogelim i kerkeses;
  - 2) inflacioni;
  - 3) ndryshime ne çmimet e kontratave;
  - 4) ndryshime ne taksa dhe sigurime;
  - 5) numri i klienteve te sherbyer;
  - 6) kostot e operimit
- 3.6 FPP do te paraqesi arsye (justifikime) per çdo rregullim te parashikuar te rezultateve te vitit te testimit. Rregullimet duhet te specifikohen ne tabelat e siguruar nga FPP ne aplikimin per tarifa dhe nje shpjegim i shkruar do te perfshihet ne aplikimin per tarifa duke siguruar evidence per arsyen (et) per çdo rregullim te rendesishem dhe shumen perkatese per secilin rregullim.
- 3.7 Furnizuesi Publik me Pakice do te pasqyroje ne menyre te veçante ne faturen e klienteve tarife nje tarife per blerjet e energjise, tarifat per sherbimet e perdorimit te rrjetit (transmetim dhe shperndarje) duke perfshire sherbimet ndihmese, dhe pagesat lidhur me detyrimet e sherbimit publik.
- 3.8 FPP do te propozoje faktoret e shperndarjes per te gjithë perberesit e te ardhurave te kerkuara per llojet e licensave midis sherbimeve te ndryshme. FPP do te paraqese faktoret e shperndarjes te bazuar e te justifikuar per tregues te tille si numri i punonjesve, numri i klienteve, niveli i shitjes se energjise dhe ngarkesa pik. Disa perberes mund te jene te lidhur direkt vetem me nje sherbim dhe prandaj te gjithë perberesit e tille duhet t'i lejohen plotesisht atij sherbimi.

#### **4. Kerkesat per te Ardhura per Sherbimet e Rregulluara te shitjes me pakice.**

- 4.1 Kerkesat per te ardhura per sherbimet e shitjes me pakice llogariten sipas menyres ne vijim:
- 4.1.1 Kerkesat per te ardhura per **sherbimet e prodhimit** perfshijne:
- a) **Kostot per blerjen e energjise per energji dhe kapacitet nga FPSH.**  
**Cmimi per energjine e shitur tek FPP per te mbuluar ngarkesen e pritshme miratohet cdo vit nga ERE ne perputhje me Metodologjite e tarifave per FPSH. Tarifa per FPSH do te supozoje nje prodhim vjetor te hidrocentraleve ne pronesi publike prej [4,200] MWh.**
  - b) FPP do te ngarkohet nga OST (operatori i tregut) per pagesat e sherbimit te disbalancimit sipas dispozitave te rregullave te tregut.
  - c) **Rregullimi** – nje rregullim vjetor i periudhes se meparshme perfshin rregullimet per energji dhe kapacitet te FPSH te krahasuar me nivelet e parashikuara.

4.1.2 Kerkesa per te ardhura per **sherbimin e rrjetit** perfshin:

Pagesa per perdorimin e sherbimit te transmetimit nga FPP per klientet tarifore :

**Kostot e OST** – Tarifa e OST eshte nje tarife e mesatare, e cila nuk eshte ndare sipas niveleve te tensionit (diferencim sipas infrastruktures dhe humbjeve); eshte aprovuar nga ERE per nje periudhe deri ne fund te vitit 2008.

Kosto e OST = OP \* DE

Ku:

OP = Tarifa e aprovuara nga ERE per OST

DE = energjia e matur qe livrohet ne rrjetin e shperndarjes nga OST per klientet tarifore

**Shenim:** kur OST te kthehet ne nje tarife me disa komponente, kjo formule do te ndryshoje ne perputhje me kete ndryshim.

4.1.3 Kerkesat per te ardhura per perdorimin e rrjetit te shperndarjes do te shperndahen nga kompania e shperndarjes midis klienteve tarifore, jo-tarifore perfshire grupet Balancuese dhe prodhuesit e lidhur ne shperndarje qe shesin energji jashte kompanise se shperndarjes. Kerkesat per te ardhura qe lidhen me perdorimin e rrjetit te shperndarjes nga FPP per t'i sherbyer klienteve tarifore, do t'u shperndahen grupeve te klienteve tarifore dhe do te perfshihen ne pagesat e rrjetit per cdo klient tarifor. Alokimi duhet te marre parasysh nivelin e tensionit dhe piken e lidhjes se konsumatorit.

Cmimet per kapacitet dhe energji per sherbimet e rrjetit perdoren per te llogaritur faturat e klienteve kur klienti ka nje mates qe mat si fuqine aktive ne kW, ashtu dhe energjine aktive ne kWh. Per te gjitha klientet cmimi per kWh reflekton shumen e kerkeses per te ardhura qe lidhen me sherbimet e rrjetit.

4.1.4 **Pagesa e konsumatorit do te perfshije edhe pagesen e furnizimit publik** – Kjo pagese mbulon koston e faturimit te konsumatorit dhe koston e arketimit te faturave, plotesimin e aplikimit per tarifa dhe permbushjen e pergjegjesive te tjera te furnizimit te FPP. Kjo pagese do te perfshije gjithashtu nje norme fitimi per FPP. Norma e fitimit e llogaritur ne perqindje mbi kostot e blerjes se energjise totale vjetore nga FPP.

Detyrimet e sherbimit publik (DSHP) percaktohen si ato sherbime qe i ngarkohen FPP perfshire sigurine e furnizimit, mbrojtjen e ambientit dhe eficencen e energjise. Te gjitha kostot qe lidhen me detyrimet e sherbimit publik ne sektorin e energjise elektrike do te paguhen ne menyre te drejte nga cdo perdorues fundor qe mer sherbim nga sistemet e transmetimit dhe shperndarjes, dhe do te mbulohen si pjese e koston se sherbimit nga te gjitha konsumatoret e energjise bazuar mbi perdorimin e saj (te matur). Shperndarja e kostove dhe menyra se si ato do te shperndahet, mbulohen dhe paguhen,

do te paraqiten dhe do te miratohen nga ERE ne perputhej me procedurat e miratuara prej saj.

4.1.5 Metoda e shperndarjes se ketyre kostove do te paraqiten ne ERE dhe do te miratohen prej saj.

4.2 Kerkesat per te ardhura (RR) qe lidhet me tarifen e perdoruesve fundore eshte shuma e kostove te cituara me lart :

$$\mathbf{RR = Kosto e Gjenerimit + Kosto e OST + Kosto e Shperdarjes + Kosto e furnizimit + Kosto e DSHP}$$

4.3 Vete-prodhuesit mund te deshirojne te blejne energji (rezerve) nga FPP bazuar ne tarifat e oprovuara nga ERE. Ne keto raste, vete-prodhuesit duhet te kontraktrojne me FPP per energji dhe kapacitet rezerve. Kosto e energjise do te jete kosto shtese e sistemit per klientet jo-familjare ne nivelin e tensionit te lidhjes se klientit dhe kosto per kapacitet do te bazohet ne koston e studimit te sherbimit per te gjithë klientet ne grupin e klienteve te “energjise reserve”.

4.4 Neqoftese FPP eshte ligjerisht i lidhur me te licensuarin e rrjetit te shperndarjes, aktiviteti i shperndarjes dhe aktiviteti i furnizimit publik me pakice **duhet te jene teresisht te ndare nga pikpamja financiare.** Nese kompanite jane ligjerisht te ndara nen nje strukture “holding”, atehere marreveshjet perfundimtare per sherbimet e ndara do t’i nenshtrohen shqyrtimit dhe miratimit te ERE-s, para se te lejohen qe kostot qe lidhen me keto marreveshje te perfshihen brenda tarifes se FPP.

## 5. Grupet e klienteve

5.1 Tarifat e rregulluara te energjise dhe kapacitetit llogariten per kater grupe kryesore klientesh:

- a) Kliente tarifore jo-familjare ne Tension te Larte, i.e., kliente me lidhje direkte ne transformatoret 110/x kV dhe 220 kV.
- b) Klientet Jo-familjare ne Tension te Mesem (35/20/10/6 kV)
- c) Kliente Jo-familjare ne Tension te Ulet (0.4 kV).
- d) Kliente familjare ne Tension te Ulet.

5.2 FPP duhet te llogarise tarifa per kater grupe kryesore klientesh duke llogaritur tarifa per cdo grup qe reflektojne me saktesi koston ekonomike te sherbimit per energjine. Tarifa mesatare e shitjeve per klientet ne transformatoret 110/x kV, tarifa mesatare e

shitjeve per klientet e tensionit te mesem, dhe tarifa mesatare e shitjeve per klientet e tensionit te ulet (familjare dhe jo – familjare), duhet te llogariten ne menyre te tille qe te mbulojne koston e vertete te sherbimit, duke perfshire koston per akses ne rrjetin e shperndarjes. Brenda secilit prej tre grupeve te klienteve jo-familjare, ERE mund te krijojte nengrupe klientesh dhe te vendose tarifa te ndryshme per cdo nengrup. Tarifat mund te perfshijne nengrupe klientesh per sa kohe qe kosto perkatese e sherbimit llogaritet dhe tarifat perfundimtare bazohen ne koston e verteta te sherbimit.

- 5.3 ERE synon te vendose tarifa energjie ne menyre te tille qe totali i te ardhurave vjetore te kerkuara nga klientet familjare te barazohet me koston e vertete te sherbimit per klientet familjare.
- 5.4 Tarifat do te bazohen ne kosto qe do te kryhen nga nje FPP i miremanaxhuar, i cili eviton shpenzimet e teperta.

## **6. Percaktimi i Tarifes se Furnizimit Publik me Pakice**

- 6.1 Faturat per klientet familjare dhe jo familjare te furnizuar ne 0.4 kV (TU) mund te perfshijne pagesat ne vijim:

- 1) Per sherbimin e prodhimit (Leke/kwh)**

- 1. Blloku i 1<sup>re</sup> (X kwh/muaj per familjaret)**

- 2. Blloku i 2<sup>re</sup> (kwh-et e mbetura mbi bllokun e 1<sup>re</sup>)**

- 2) Per sherbimin e transmetimit (Leke/kwh)**

- 3) Per sherbimin e shperndarjes (Leke/kWh)**

- 4) Per sherbimin e furnizimit (fikse ne Leke/muaj)**

- 5) Per Detyrimin e Sherbimit Publik, nese ka (Leke/kWh)**

- 6.2 Faturat per cdo grup te klienteve jo-familjare, sipas nivelit te tensionit ku ato furnizohen, mund te perfshijne pagesat e vecanta si vijon:

- 1) Per sherbimin e prodhimit (Leke/kwh)**

- a. pagese per kapacitet (leke/kW)

- b. pagese per energji (leke/kWh)

- 2) Per sherbimin e transmetimit (Leke/kwh) ndare ne**

- a. Pagese per Kapacitet (Leke/kW);

- b. Pagese per energji (Leke/kWh)

**3) Per sherbimin e Shperndarjes (leke/kWh), ndare ne**

- a) Pagese per Kapacitet (Leke/kW);
- b) Pagese per energji (leke/kWh);
- c) Pagese per fuqine reaktive

**4) Per sherbimin e furnizimit (ne Leke/muaj);**

**5) Per Detyrimet e Sherbimit Publik, nese ka (Leke/kWh)**

- 6.3 Per klientet tarifore ne tension te larte dhe te mesem, fatura mujore nga FPP do te perfshije nje pagese kapaciteti. Pagesa e kapacitetit do te jete Zero Leke/muaj deri sa klienti te instaloje mates elektronik qe regjistron dhe ruan kerkesen orare te klientit. Matesit elektronik duhet te lejojne llogaritjen e fluksit te energjise reaktive .
- 6.4 FPP mund te kerkoje te aplikoje tarifa me blloqe per konsumatoret jo familjare sipas nje studimi te paraqitur ne ERE te bazuar ne nje sistem matjeje te pershtatshem;
- 6.5 FPP duhet te vendose nese klienteve duhet gjithashtu t'u kerkohet te paguajne energjine reaktive ose te instalojne kompensatore/ reaktore te energjise reaktive.
- 6.6 Pagesat per prodhimin nga FPSH, per kapacitet dhe energji, shperndahet tek te 4 klasat e konsumatoreve.

**Per konsumatoret familjare dhe jo familjare qe furnizohen ne 0.4 kV (TU):** pagesa per energji llogaritet si shume e kostove te kapacitetit dhe variabel, pjestuar me shitjet e energjise elektrike te parashikuara per keto grupe.

**Per grupet e tjera te konsumatoreve jo familjare:** (i) pagesa per kapacitete prodhuese llogaritet si kosto totale e kapacitetit per grupin (et) e konsumatoreve, pjestuar me shumen e kerkeses pik koicidues per grupin perkates te konsumatoreve; (ii) pagesa per energjine e prodhuar llogaritet si shume e kostove variabel qe lidhen me grupin (et) e konsumatoreve, pjestuar me totalin e shitjeve te energjise ne grupin perkates te konsumatoreve.

- 6.7 Pagesat per sherbimin e transmetimit nga OST, ne kapacitet dhe energji, do te shperndahet te te 4 klasat e konsumatoreve;

**Per konsumatoret familjare dhe jo familjare qe furnizohen ne 0.4 kV (TU):** pagesa per energji e sherbimit te transmetimit llogaritet si shume e kostove te kapacitetit dhe kostove variabel qe lidhen me kete grup, pjestuar me totalin e shitjeve te energjise te parashikuar.

**Per grupet e tjera te konsumatoreve jo familjare:** (i) pagesa per kapacitete transmetuese llogaritet si kosto totale e kapacitetit te transmetimit per grupin (et) e konsumatoreve, pjestuar me shumen e ngarkeses pik jo koicidues per grupin perkates te konsumatoreve; (ii) pagesa per energji e sherbimit te transmetimit



llogaritet si shume e kostove variabel qe lidhen me grupin (et) e konsumatoreve, pjestuar me totalin e shitjeve te energjise ne grupin perkates te konsumatoreve.

- 6.8 Pagesat per sherbimin e shperndarjes nga DSO, ne kapacitet dhe energji, do te shperndahet te te 4 klasat e konsumatoreve

**Per konsumatoret familjare dhe jo familjare qe furnizohen ne 0.4 kV (TU):** pagesa per energji e sherbimit te shperndarjes llogaritet si shume e kostove te kapacitetit dhe kostove variabel qe lidhen me kete grup, pjestuar me totalin e shitjeve te energjise te parashikuar.

**Per grupet e tjera te konsumatoreve jo familjare:** (i) pagesa per kapacitete te shperndarjes llogaritet si kosto totale e kapacitetit te shperndarjes per grupin (et) e konsumatoreve, pjestuar me shumen e ngarkeses pik jo koincidues per grupin perkates te konsumatoreve; (ii) pagesa per energji e sherbimit te shperndarjes llogaritet si shume e kostove variabel qe lidhen me grupin (et) e konsumatoreve, pjestuar me totalin e shitjeve te energjise ne grupin perkates te konsumatoreve.

- 6.9 Pagesa per Klientet llogaritet si kosto e furnizimit te alokuar per cdo klase te konsumatoreve, pjestuar me numrin e konsumatoreve qe bejne pjese ne klasen perkatese.

- 6.10 Pagesa te vecanta per detyrimin e sherbimit publik do te percaktohen rast pas rasti, ku ERE do te percaktoje alokimin e drejte te kostove qe lidhen me Detyrimet e Sherbimit Publik per te gjithë grupet e klienteve.

- 6.11 Pagesat e Shperndarjes per Klientet e Kualifikuar  
 $ECDS = [ECADV + ECADC + ECATL] / THES$

Ku:

ECDS = Tarifa e Sherbimit te Shperndarjes per Klientet e Kualifikuar  
ECADV = Kosto Variabel e Shperndarjes e Alokuar (duke perfshire vetem koston e humbjeve teknike)  
ECADC = Kosto e Alokuar e Kapacitetit te Shperndarjes  
TES = Shitjet totale te energjise

## 7. Standartet per Cilesine e Sherbimit

- 7.1 FPP-se do t'i kerkohet qe te zbatoje nje program i cili do te perfshije te pakten kater tregues te cilesise se sherbimit. Standarte e sherbimit do te perfshijne te pakten:

*Cilesine e Sherbimit:*

- Koha mesatare per t'iu pergjigjur nje kerkese te klientit;
- Numri mesatar i ankesave te klienteve te pazgjidhura pas 30 diteve

*Siguria e furnizimit me Energji*

- Indeksi i kohezgjatjes se derprerjeve vjetore te Klienteve (CAIDI)

*Cilesia e Energjise*

- Perqindja e kohes ne te cilen niveli i tensionit eshte nen standard ne cdo nenstacion te shperndarjes gjate periudhave ne pik.

- 7.2 Programi i cilesise se sherbimit dhe te energjise do te administrohet nga FPP. Ne masen qe ERE llogarit (vlereson)nje gjobe qe ka lidhje me mosrealizimin e objektivave vjetore per sigurine dhe cilesine e furnizimit me energji nga cdo I licensuar tjetër (OSSH, OST dhe /ose FPP), kjo gjobe do te zbritet nga pagesat qe FPP I bent e licensuarve te tjere.
- 7.3 Metodologjia e tarifes se furnizuesit publik me pakice do te rregullohet ne menyre qe te lejoje rregullimet e cmimeve te FPP per mosrealizimin e objektivave vjetore te performances.

## **8. Pagesat per energjine pik dhe jashte-pikut.**

- 8.1 FPP mund te propozoje nje tarife shitjeje me pagesa per energjine pik dhe jashte-pikut, ne leke/kWh, ne menyre qe te reflektoje diferencen midis cmimit te energjise gjate oreve pik dhe cmimit te energjise gjate oreve jashte-pikut.
- 8.2 Percaktimi i periudhave te kohes pik dhe jashte-pikut do te vendoset nga ERE ne baze te propozimit te paraqitur nga FPP.

## **9. Raportimi**

- 9.1 FPP duhet te paraqese ne ERE deri ne 30 Prill te cdo viti raportin vjetor te vitit te meparshem ne perputhje me Sistemin Uniform te LLogarive te aprovuar nga ERE.

## **10. Dispozita Kalimtare.**

- 10.1 Tarifa per furnizimin publik me pakice fillon ne 1 Mars.
- 10.2 Tarifat per 2011 do te mbeshteten ne te dhena financiare ne perputhje me IFRS dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe Raportimit.

- 10.3 FPP do te propozoje ERE-s ne 31 Dhjetor te 2008 standartet qe lidhen me cilesine e sherbimit dhe objektivat vjetore per arritjen e ketyre standarteve si dhe detaje per menyren se si keto te dhena do te mblidhen, analizohen dhe raportohen ne ERE
- 10.4 Marzhi i fitimit per 3 periudhat e para te rregullimit nga 2009 deri ne 2013 do te percaktohet nga ERE ne nje dokument te vecante. Pas kesaj ERE do te vleresoje nivelin e pershtatshem te marzhit te fitimit per periudhat ardhme te rregullimit.
- 10.5 Tarife e vecante per sherbimin e mosbalancimit do te hyje ne fuqi ne vitin 2010

## **11. Dispozita Perfundimtare**

Metodologjia e Llogaritjes se Tarifave te Sherbimit te Shitjes me Pakice u aprovua nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me Vendimin Nr. 80, date 26/06/2008.

## **Pjesa II**

Formatet Standarte te Tabelave